



SHKURTIMISHT RRETH SEKTORIT

Rrjeti transportues në Ballkanin Perëndimor ende kërkon financim të orientuar duke qenë se një pjesë e konsiderueshme e rrjetit rrugor dhe hekurudhor në rajon kërkon rikonstruktim dhe përmirësim. Gjithashtu, zgjidhja e barrierave jomateriale, të cilat ndikojnë në tregti dhe qarkullim në rajon (përputhshmëria reciproke, siguria, menaxhimi i qarkullimit për të gjitha llojet e transportit) është e domosdoshme.


Në vitin 2015 udhëheqësit e Ballkanit Perëndimor janë harmonizuar dhe kanë rënë dakord me Rrjetin Rajonal bazë të transportit dhe zgjatjen indikative të Rrjetit bazë dhe Korridorit të BE-së, me qëllim të përmirësimit të lidhjes në kuadër të rajonit dhe lidhjes së mëtejshme me rrjetin e BE-së. Firmosja e Marrëveshjes së Komunitetit të Transportit nga viti 2017 nxit planifikimin e investimeve të transportit dhe avancimit të procedurave. Sekretariati i ri i Bashkësisë së Transportit ndodhet në Beograd dhe ka rol udhëheqës në zhvillimin e politikave dhe mekanizmave të bashkëpunimit në rajon.

PRIORITETET DHE AKTIVITETET E WBIF

Transporti është sektori më aktiv i WBIF dhe përbën 45% të portofolit të tij. WBIF siguron grante për mbështetjen teknike, me qëllim të hartimit të projekteve që janë pjesë e Rrjetit Bazë. Me anë të granteve investuese bashkëfinancohen projektet infrastrukturore në korridoret kryesore, ku përdoren fondet e alokuara në shumën prej 1 miliardë eurosh në dispozicion për investimet në lidhje për periudhën 2015-2020. Përfituesit kryesorë të mjeteve janë sektori rrugor dhe hekurudhor.

GRANTET E WBIF SIPAS NËNSEKTOREVE

Nënsëktorët e transportit (në mil. €)



- Rrugët
- Hekurudhat
- Portet detare dhe lumore
- Transporti urban
- Studimet rajonale sektoriale




Western Balkans Investment Framework **WBIF**
BUILDING THE EUROPEAN FUTURE TOGETHER

PROJEKTE	VLERA E PËRL-LOGARITUR E PROJEKTEVE	PROJEKTET ME HUA TË FIRMOSURA	GRANTET E WBIF	GRANTET E WBIF NË 2019
55	€9.4 mld	25/€3.3 mld	€834.7 m	€162.8 m

REZULTATET E ARRITURA





REZULTATET E PRITSHME



GRANTET E WBIF SIPAS PËRFITUESVE

Vlera e granteve (në mil. €)

Numri i granteve



- Shqipëria
- Mali i Zi
- Bosnja Hercegovina
- Kosova*
- Maqedonia e Veriut
- Serbia
- Projektet rajonale

SHEMBUJT E PROJEKTEVE



Korridori Lindor/i Mesdheut Lindor: Rikonstruktimi i aksit hekurudhor 10 në Kosovë



Korridori Lindor/i Mesdheut Lindor përshkon Kosovën nga veriu deri në jug në aksin 10 dhe përbën lidhjen hekurudhore të këtij vendi me rajonin e gjerë. E gjithë hekurudha është në gjendje të keqe, me kufizime serioze strukturale, të cilat e kufizojnë qarkullimin në 60 km/h. Aksi 10 është pjesë e zgjatjes së rrjetit TEN-T deri te Ballkani Perëndimor, me gjatësi të totale prej 256 km, prej të cilëve 148 km janë në Kosovë.

Rikonstruktimi i aksit në Kosovë do të zhvillohet në tri faza:

- Faza 1: Fushë Kosovë – kufiri me Maqedoninë e Veriut (64 km);
- Faza 2: Fushë Kosovë – Mitrovicë (35 km);
- Faza 3: Mitrovica – kufiri me Serbinë (49 km).

I gjithë aksi do të avancohet deri në nivelin e standardit TEN-T. Shpejtësia e transportit automobilistik dhe mallrave do të rritet deri 100-120 km/h, duke ulur kohën e udhëtimit midis Prishtinës, Shkupit dhe Beogradit për gjysëm ore.

Punimet e ndërtimit në kuadër të fazës së 1 kanë filluar në korrik të vitit 2019, ndërsa fillimi i punimeve në kuadër të fazës së 2 planifikohet për fundin e vitit 2020. Për sa i takon fazës së 3, aktualisht po hartohet projekti i detajuar. Pas vënies në punë, ky aks do të mundësojë interoperabilitetin e hekurudhës në Kosovë duke siguruar shërbime të sigurta të transportit për popullsinë dhe sektorin e biznesit në rajon dhe më gjerë në Evropë.



Stacioni Hekurudhor Fushë Kosovë (c) EU

VLERA TOTALE E PËRLLOGARITUR E PROJ.:	€251.7 m
GRANTET E WBIF:	€84.3 m (INV)
	€5.6 m (TA)
HUATË E FIRMOZURA:	€39.9 m (EBRD)
	€42 m (EIB)
PËRFUNDIMI PRITET:	në fund të vitit 2023 (fazat 1 & 2)



R2 Ndërlidhja rrugore midis Bosnja Hercegovinës dhe Kroacisë, Banja Luka – Gradishka dhe ura e Gradishkës



Ky projekt investues i referohet ndërtimit të pikës kufitare, urës ndërkufitare mbi lumin Sava, si dhe lidhjes rrugore në aksin Banja Luka – Gradishka. Konstruksione të reja ndodhen përgjatë aksit 2a (R2a), me gjatësi prej 239 km, nga Lashva dhe Banja Luka në Bosnja Hercegovinë deri te Okučan në Kroaci. Në këtë mënyrë ajo lidh Bosnja Hercegovinën me akset kryesore në Kroaci të cilat çojnë drejtë porteve adriatike.

Autostrada R2 aktualisht përshkon pjesën urbane të Gradishkës në gjatësi prej rreth 2 km duke kaluar urën dydrejtimshe me gjatësi prej 260m mbi lumin Sava. Ura e re dhe objektet ndërkufitare në Gradishka po ndërtohen në rreth 3 km në perëndim të objekteve ekzistuese, jashtë pjesës urbane të Gradishkës. Ndërtimi i urës ka filluar në Shtator të vitit 2019.

Pas vënies në punë, objektet e reja do të sigurojnë një transport rrugor të sigurt dhe efikas për më shumë se 500,000 banorë të cilët përdorin autostradën R2, kapacitetet e transportit automobilistik dhe të mallrave do të përmirësohen në mënyrë të konsiderueshme, ndërsa koha e pritjes në kufirin midis Bosnje Hercegovinës dhe Kroacisë do të ulet për 2-5 minuta për makinat dhe 12-30 minuta për kamionët.

Kapacitetet e urës së re do të përbushin edhe nevojat e transportit të autostradave në akset rrugore Banja Luka – Gradishka dhe Banja Luka – Doboj.



Dizajni i propozuar për Urën e Gradishkës mbi lumin Sava, BH (c) Autoputevi RS

VLERA TOTALE E PËRLLOGARITUR E PROJ.:	€38.5 m
GRANTET E WBIF:	€7 m (INV)
HUAJA E FIRMOZURA:	€10.7 m (EIB)
PËRFUNDIMI PRITET:	mesi i vitit 2022